

DREJTORIA E PERGJITHSHME ARSIMORE N.II E UDINES

SHKOLLA FILLORE DHE SHKOLLA E MESME

Rregullat per parandalimin e perhapjes se COVID-19

Shpjegimi ne gjuhen:Shqipe

Prinder,duhet ti shpjegoni sa me mire femijeve tuaj si duhet te sillen ne shkollë

1. Me ndihmen e prinderve,matni temperaturën perpara se te dilni nga shtepia.Ne qofte se i kalon 37.5°C ose keni shenja gripi,qendroni ne shtepi.Prinderit do te flasin ne telefon me pediatren.
2. Vendos ne cante nje maske kirurgjike rezerve,facoleta prej letre dhe nje xhel disinfektues qe do ta perdoresh vetem ti.Ne qofte se perdor maske prej lecke duhet ta lash cdo dite.
3. Ne qofte se vjen ne shkollë me autobus,mbaj masken dhe distancën te pakten 1 meter nga pasagjeret e tjere.
4. Nderroje masken cdo dite ose kur eshte zbutur,mundohu mos ta prekesh shpesh apo ta vendosesh ne sipërfaqe qe nuk jan te disinfektuara.Mos e vendos as ne qafe as ne krah.
5. Duhet me qene korrekt.Mos hajde ne shkollë me vonese ose para kohe.
6. Vendos masken kur te hysh e kur te dalesh nga shkollë.
7. Disifekto duart perpara se te hysh ne shkollë.
8. Kur te hysh ne klase shko ne vendin tend.Vendos xhupin te karrikja dhe canten poshte karrikes ose poshte bankes.Kontrollo qe banka te jete ne vendin e duhur(shiko ngjiteset ne dysHEME),qendro ulurdhe prit fillimin e mesimit.Hiqe masken vetem kur mesuesi te jete prezent.
- 9.Vendos masken ne qofte se nuk mban distancën 1 meter nga personat e tjere.
- 10.Vendos gjithmone masken kur leviz nga banka jote.Gjate mesimit mund ti kerkosh mesueses per te dale nga klasa vetem per te shkuar ne banjo.
- 11.Perdor banjot e caktuara per klasen tende.
- 12.Nderkohe qe jeni ne pritje per te hyre ne banjo,mbaj distancën 1 meter nga personat e tjere pa penguar kalimin.
- 13.Dritaret ne shkollë do te hapen shpesh per ajrosje,kujtohu qe te maresh me vete nje triko/pulover me shume.
- 14.Gjate dites laj dhe higjenos duart sa me shpesh,para dhe pasi te kesh prekur sipërfaqe te perbashketa.Perdor mjetet higjenuese ne dispozicion ose xhelin higjenues personal.
- 15.Gjate ores se pushimit qendro ne territorin e caktuar te klases.
- 16.Ne qofte se duhet te shkosh ne palester ose ne laborator,vendos masken,prit mesuesen edhe shko bashke me shoket duke respektuar distancën 1 meter.
- 17.Gjate aktivitetit sportiv,mund te heqesh masken vetem ne rast se mban distancën 2 metra nga persona te tjere.Ndiq udhezimet e mesuesve!
- 18.Per te kenduar duhet me qene larg 2 metra nga personat e tjere.
- 19.Nuk mund te shkembesh me shoket materiale ose gjera te tjera,as ushqim apo pije.
- 20.Shkruaj emrin ne te gjitha objektet personale,edhe tek bidoni i ujit.
- 21.Te gjitha informacionet shkollë-familje dhe justifikimet behen ne regjistrin elektronik.Pyet prindin nese ka passwordin.Kontrollo vazhdimisht sitin dhe faqen ne microsoft per njoftime.
- 22.Nese ndihesh keq ne shkollë lajmero mesuesen ose rojen qe ndodhet me afer.Do te shoqerohje ne nje klase ku do presesh prinderit per tu kthyer ne shtepi.Sapo te mberrini ne shtepi,merni ne telefon pediatrin dhe i shpjegoni situaten.
- 23.Ne qofte se mungoni 1 dite,mund te riktheheni me vertetim nga mjeku.Ne qofte se mungoni me shume se 3 dite mund te riktheheni vetem me certifikate mjeku.
- 24.Ne qofte se mungoni ne shkollë per arsye familjare ose personale duhet me lajmeruar kordinatorin e klases.Per tu rikthyer ne shkollë,prinderit duhet te dorezojn nje deklarate ku vertetojn qe keni bere mungesa per arsye personale dhe jo per semundje.